33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34

Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35

Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Neni 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36

Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-23-639-5-1-1/C746

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 25 muaj. Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitim e sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës sipas urdhërësës me shkrim nga menaxheri i projektit
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 520 ditë pune, brenda 24 muajve nga nënshkrimi i kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit

		përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë.	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 37 muaj pas pranimit të punëve të kryera.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Projekti kryesor i rregullimit të shtratit të lumit Krena pjesa IV-1 (Pjesa Veriore), Gjakovë					
Lumi					
Paramasa dhe Paralogaria Aksi 1					
L=0+249.45km, B=19.00 m, b=2.5 m					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I	Punët Pregaditore				
1	Punët pregaditore për fillimin e punimeve, mobilizimi i punishtes me zyre (zyrja te ketë hapsire edhe për tavolina pune-takimeve për organin mbikëqyrës dhe projekt menaxherin dhe internet) dhe shenjat dhe mjetet mbrojtëse te nevojshme per siguri dhe paralajmerim të vendpunishtës	komplet	1.00	4,396.42	4,396.42
2	Pastrimi i termit, prerja e shkurreve, ruajtja e instalimeve si dhe largimi i mbetjeve drusore të kalburave dhe mbeturinave tjera nga fundi dhe anash shtratit të lumit dhe bartja e mbetjeve ne deponi te caktuar nga Investitori, max 10 km.	m'	249.45	5.00	1,247.25
3	Shenjëzimi i trasesë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet	m'	249.45	5.00	1,247.25
4	Devijimi i ujit te lumit gjatë realizimit të punëve në shtatitn e lumit, si dhe rregullimi i terenit pas kthimit te rrjedhjes se ujit ne shtratin e vet.	m'	249.45	10.00	2,494.50
5	Zhvendosja e shtyllave ekzistuese nga betoni, me bazament te betonit duke perfshire germimin per bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m, vendosjen e betonit, shiritin e tokezimit Fe/Zn 25x4mm(3.5mm), reren e imet, montimin e unazes, vendosja e konzolles (per rrjet ajror 0.4kV), trupave ndriçues (nese ekziston) si dhe demontimi dhe montimi i serishem i kablllove ekzistuese ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjeter i nevojshem komplet me ateste per një shtylle te dislokuar.	copë	2.00	150.00	300.00
6	Inçizimi dhe punimi i projektit te gjendjes se ekzekutuar (nese projekti ka ndryshime gjate ekzekutimit)	m'	249.45	1.00	249.45
Gjithsej totali me TVSH					9,934.87
II	Punët e Gjermimit				
1	Gjermimi i dheut te kategoris III-IV ne fundin dhe brigjet e lumit si dhe hapja e themeleve për muret mbrojtëse, gjermimi për sanimin e shtratit dhe themelet në vendet ku është e nevojshme. Materiali i gjermuar duhet të klasifikohet dhe i njajti mund të përdoret për rregullimin e brigjeve të lumit dhe mbushjen e skarpateve, ndërsa pjesa e mbetur, se bashku me materialin humosor dhe me permbajtje të lartë të materieve organike, duhet të bartet në deponin legale të përshtatshme në largesi deri në 15 km.	m³	6,205.90	2.00	12,411.80
Gjithsej totali me TVSH					12,411.80



III	Punët e Objekteve				
1	Punimi e mvëshjes së lumit me gurë				
1	Furnizimi dhe vendosja e gurëve natyrore me trashësi $t_{mes}=20cm$ në skarpate të lumit (të ngjashëm me gurët ekzistues). Vendosja e gurëve behet në betonin hidroteknik C-25/30, $t=10\text{ cm}$ (duke e llogaritur edhe një rrjetë armatur Q-335). Materiali lidhes për mbushjen e fugave duhet të jete laç çimento, fugat te percillen në madhesi të atyre ekzistuese.	m^2	1,913.08	45.00	86,088.60
2	Furnizimi dhe vendosja e gurëve natyrore me trashësi $t_{mes}=20cm$ në shtratin e lumit nga st: P1 0+000.00 km - P2 0+65.50km (të ngjashëm me gurët ekzistues). Vendosja e gurëve behet në betonin hidroteknik C-25/30, $t=10\text{ cm}$ (duke e llogaritur edhe një rrjetë armatur Q-335). Materiali lidhes për mbushjen e fugave duhet të jete laç çimento, fugat te percillen në madhesi të atyre ekzistuese.	m^2	954.20	40.00	38,168.00
2	Punimi i Mureve mbrojtëse me $h=3.0-4.00m$				
1	Furnizimi, prerja, lakimi, montimi i armatures se brinjzuar S400/500 profile $\varnothing 8\text{ mm}$, $\varnothing 10\text{ mm}$, $\varnothing 12\text{ mm}$ në pozicione sipas projektit	kg	31,986.00	0.70	22,390.20
2	Furnizimi dhe vendosja në veper e betonit hidroteknik C-30/37 për betonimin e mureve mbrojtëse së bashku me themelet në skarpatet e lumi, duke e llogaritur edhe kallupimin. Muret kanë lartësi mesatare $h=3.0-4.0\text{ m}$.	m^3	454.20	120.00	54,504.00
3	Furnizimi dhe vendosja në veper e betonit hidroteknik C-25/30 për betonimin e traut shtangues me dimensione $a \times b=70 \times 50\text{ cm}$ në tër gjatësinë e mureve të lumit, duke e llogaritur armimin minimum $4\varnothing 12\text{ mm}$, stafa $\varnothing 8\text{ mm}/25\text{ cm}$ dhe kallupimin.	m^3	128.80	120.00	15,456.00
4	Furnizimi dhe lyrja e murit në të dy anet me material hidroizoluese (jo ujëpërshruesë-të lëngshëm),	m^2	542.00	2.00	1,084.00
5	Furnizimi dhe shtrirja e gypit drenazhues (te brinjzuar) $\varnothing 160\text{ mm}$	m'	149.40	3.00	448.20
6	Furnizimi dhe shtrirja e gjeotekstilit për drenazhim, $250\text{ gr}/m^2$	m^2	143.42	1.50	215.14
7	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorrit 20-40 mm për drenazhim	m^3	20.70	10.00	207.00
Gjithsej totali me TVSH					218,561.14
IV	Punët e Zhavorit				
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorrit 0-31mm $t=10\text{ cm}$, nën shtratin e rregulluar të lumit, gjegjesisht nën pllakën e betonit. Materiali duhet të jetë i përshatshëm për planifikim në teren të pjerrët.	m^3	222.93	12.00	2,675.16
2	Furnizimi, shtrirja dhe kompaktësimi i materialit gurorë 0-150mm $t=55\text{ cm}$ për sanimin e nënbazës së themeleve, dhe mbushjen e bankinave të shtratit të lumit sipas projektit.	m^3	3,005.57	8.00	24,044.56
3	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorrit 0-63mm, $t=25\text{ cm}$ nën bazën e themeleve të mureve mbrojtëse. Moduli i shafitjes duhet të jetë $M_v > 40\text{ Mpa}$.	m^3	80.00	10.00	800.00
4	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorrit 20-40 mm për drenazhim	m^3	53.95	10.00	539.50



Gjithsej totali me TVSH					28,059.22
V	Punët Tjera				
1	Furnizimi dhe rrafshimi dhe perpunimi i dheut per pjesen jasht shtratit të lumit. Ne çmim te perfshihet edhe humusimi i shtreses se sipërme dhe mbjellja e barit 100gr/m²	m²	550.00	2.00	1,100.00
2	Furnizimi dhe montimi i tabelat informuese me informata për lumin.	copë	2.00	100.00	200.00
Gjithsej totali me TVSH					1,300.00
VI	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit				
1	Testimet e Ngjeshmëris	komplet	1.00	100.00	100.00
2	Testimet Betonit	komplet	1.00	100.00	100.00
Gjithsej totali me TVSH					200.00

Rekapitulimi		
I	Punët Pregaditore	9,934.87
II	Punët e Dheut	12,411.80
III	Punët e Objekteve	218,561.14
IV	Punët e Zhavorit	28,059.22
V	Punët Tjera	1,300.00
VI	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit	200.00
Gjithsej totali me TVSH		270,467.03

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E RREGULLIMIT TË SHTRATIT TË LUMIT KRENA - GJAKOVË					
st. 3+247.80 DERI st. 3+696.50					
L=400.83 m					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I	Punet pregaditore				
1	Punët pregaditore dhe mobilizimi i ndermarrjes per fillimin e punimeve	komplet	1.00	1,000.00 €	1,000.00 €
2	Shënjim i trases me të gjitha elementet gjeodezike, sipas elementeve të trases dhe shënimeve në projekt, si dhe përcjella e punimeve gjatë ekzekutimit	m'	400.83	5.00 €	2,004.15 €
3	Pastrimi i terenit, zbulimi i trasese, prerja e shkurreve, prerja e trupzave, drunjeve te ndryshem, largimi i gurëve me dimensione të ndryshme dhe të gjithë materialit te ndryshem te hedhur në teren. Në çmim te llogaritet pastrimi dhe bartja deri në deponi e materialeve	m'	400.83	5.00 €	2,004.15 €



 Shtetësi me përgjegjësi të kufizuar

 s.p.k.

 VETOFJA

 020962103

 JUNIK

4	Kontrolli dhe ruajtja e instalimeve nëntoksore gjatë realizimit të punimeve.	m'	400.83	1.50 €	601.25 €
5	Devijimi i stralit të lumit gjatë punës. Devijimi duhet të bëhet në tërë gjatësinë e lumit.	komplet	1.00	10,000.00 €	10,000.00 €
6	Demolimi Mureve nga beton duke përfshirë edhe themelet, si dhe largimi i materialit deri në deponi.	m'	50.00	30.00 €	1,500.00 €
7	Demolimi i pllakave nga betoni në fundin e shtratit të lumit, si dhe bartja e materialit të demoluar deri në depo.	m ²	30.00	5.00 €	150.00 €
8	Demolimi i urës ekzistuese të këmbësorëve. Ura është e punuar nga profilet metalike me pllakë nga betoni. Po ashtu duhet të demolohen edhe muret bregore nga betoni si dhe themelet e mureve. Gjatësia e urës është L=10.00 m, dhërsa gjatësia e kriheve L= 13.00 m. Materiali i demoluar transportohen ne deponin e caktuar nga Investitori max 15 km	copë	1.00	2,000.00 €	2,000.00 €
9	Largimi i kyqeve të kanalizimit në shtratin e lumit.	copë	10.00	10.00 €	100.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POS I					19,359.55 €
II	Punët e dheut dhe te Zhavorit				
1	Gërmimi i gjërë me makinë i dheut të kategorisë III-IV dhe largimi i dheut të tepert deri në deponine e caktuar nga Investitori deri në 10 km.	m ³	17,319.31	2.00 €	34,638.62 €
2	Planifikimi i shtratit të lumit me makineri dhe me dorë me saktësi prej ±1 cm dhe ngjeshja e bazës në tërë sipërfaqen e shtratit të lumit.	m ²	9,535.71	0.50 €	4,767.86 €
3	Furnizimi me material, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej zhavorit 0/150 mm me trashësi minimale 40 cm.	m ³	2,679.00	7.00 €	18,753.00 €
4	Furnizimi dhe vendosja e zhavorit të granular 0/31.5 mm nën shtratin e rregulluar të lumit, gjegjësisht nën plakën e betonit. Trashësia t=10 cm. Materiali duhet të jetë i përshtatshëm për planifikim në teren të pjerrët.	m ³	1,399.00	12.00 €	16,788.00 €
5	Planifikimi i dheut të pjesës jashtë shtratit të lumit dhe rregullimi i gjelbrimit me bare 100gr/m ²	m ²	1,203.66	2.00 €	2,407.32 €
Gjithsej totali me TVSH - POS II					77,354.80 €
III	Punët e betonit				
III.1	Pragjet (Kaskadat)				
1	Furnizimimi me material dhe punimi i kaskadave, në pozitat e parapara me projekt. Kaskadat punohen nga betoni hidroteknik i klasës C-25/30. Trashësia e murit të kaskadës do të jetë t= 100 cm, ndërsa lartësia sipas lartësië në profil tërthorë.	m ³	164.15	120.00 €	19,698.00 €
2	Furnizimi dhe vendosja ne veper e betonit hidroteknik C-25/30 për betonimin e traut shtangues me dimensione axb=70x50cm ne tërë gjatësin e mureve te lumit, duke e llogaritur armimin minimum 4 Ø12 mm, stafa Ø 8mm/25cm dhe kallupimin.	m ³	282.00	120.00 €	33,840.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POS III.1					53,538.00 €
III.2	Punimi i mureve mbrojtëse				



1	Furnizimi me material dhe vurma në vepër e betonit C-25/30 për betonimin e themelit dhe mureve mbrojtëse duke e llogaritur edhe kallupimin	m ³	465.86	120.00 €	55,903.20 €
2	Furnizimi, punimi i armatures se brinjezuar S400/500 profile Ø 8 mm, Ø 10 mm, Ø12 mm, Ø 14 mm	kg	24,534.45	0.70 €	17,174.12 €
Gjithsej totali me TVSH - POS III.2					73,077.32 €
Gjithsej totali me TVSH - POS III					126,615.32 €
IV	Punimi i shtratit të lumit (Punët e Gurit)				
1	Furnizimi me material dhe vendosja e gurëve natyrore me trashësi mesatarisht t=30 cm. Vendosja bëhet mbi një shtresë betoni të freskët me trashësi mesatare t=10 cm të klasës C-25/30. h= 30 + 10 = 40 cm.	m ²	4,200.00	50.00 €	210,000.00 €
2	Furnizimi me gure dhe mbeshja e mureve mbrojtëse për-rreth brigjeve të shtratit të lumit me trashësi mesatare të gurëve t=10 cm. Meshja bëhet me llaç çimentoje.	m ²	480.56	25.00 €	12,014.00 €
3	Furnizimi me material dhe punimi i fundit të kokës së zbrazjës së lumit me gurë natyral me trashësi h= 80 cm të vendosur mbi një shtresë betoni të freskët me trashësi mesatare t=10 cm. Sipas detallit të prezantuar në projekt.	m ²	168.00	25.00 €	4,200.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POS IV					226,214.00 €
V	Punët tjera				
1	Punimi kokës së shkarkimin e kanalizimit në lumë. Në kyqje duhet të behet furnizimi dhe vendosja gypit Ø315 ose Ø200 me gjatësi mesatare L=5 m. Në këtë pozicion duhet të parashihet edhe lidhja me gypin ekzistues	copë	10.00	40.00 €	400.00 €
2	Pastrimi i terenit dhe largimi i mbeturina ne deponi legale	komplet	1.00	200.00 €	200.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POS V					600.00 €

Rekapitullimi		
I	Punet pregaditore	19,359.55 €
II	Punët e dheut dhe te zhavorit	77,354.80 €
III	Punët e betonit dhe armatures	126,615.32 €
IV	Punimi i shtratit të lumit (Punët e Gurit)	226,214.00 €
V	Punët tjera	600.00 €
Gjithsej totali me TVSH		450,143.66 €


- Segmenti i dytë me gjatësi L2=0+400.83 km, i projektuar nga Albi Ing, Maj 2014.

- Te ky segment nga gjendja e projektuar është shtuar edhe ura për kembsor në st :0+210.36 km dhe po ashtu është hekur rregullimi i pjesë se poshtme te shtratit te lumit dhe është shtuar një tra shtanguesë 70x50 cm



**PARAMASA DHE PARALLOGARIA
- RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT KRENA
PREJ ST.2+640.50-ST.3+247,80**

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1,0,0	PUNËT PARAPRAKE				
1,0,1	Mobilizimi i kompanisë për fillimin e punimeve si dhe transporti i makinerisë së nevojshme në katinier.	komplet	1.00	1,000.00	1,000.00
1,0,2	Shenimi i trasesë para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit.	m'	305.44	5.00	1,527.20
1,0,3	Prerja largimi i drunjëve përgjatë tërë trasesë së projektuar dhe pastrimi i terrenit.	m'	305.44	5.00	1,527.20
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT PARAPRAKE					4,054.40
2,0,0	PUNIMET E DHEUT				
2,0,1	Gërmimi i dheut i kategorisë së III-të me makine, me ngarkim dhe bartje deri në deponi legale në largësi 10km.	m³	12,788.68	2.00	25,577.35
2,0,2	Gërmimi i dheut i kategorisë së III-të me dorë, me ngarkim dhe bartje deri në deponi legale në largësi 10km	m³	1,991.00	2.50	4,977.50
2,0,3	Rrafshimi i nënbazës me ngjeshje me cilindër me vibracion	m²	6,562.50	0.50	3,281.25
2,0,4	Punimi i mbushjes me material guror jokoherent të sjellur nga huaza legale në largësi 10 km me bartje, shtrirje në shtresa dhe ngjeshje	m³	567.00	10.00	5,670.00
Gjithsej totali me TVSH - PUNIMET E DHEUT					39,506.10
3,0,0	PUNËT E ZHAVORIT				
3,0,1	Sigurimi, transportimi, planifikimi dhe ngjeshja e tamponit prej zhavorit 0-60mm me trashësi d=10cm sipas detalit.	m³	687.61	12.00	8,251.32
3,0,2	Sigurimi, transportimi, planifikimi dhe ngjeshja e tamponit prej zhavorit 0-100mm me trashësi d=40cm si bazament i rregullimit.	m³	2,859.83	10.00	28,598.30
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT E ZHAVORIT					36,849.62
4,0,0	PUNIMET BETONUSE DHE MURATUSE				
1	Furnizimi dhe vendosja në vepër e betonit hidroteknik C-25/30 për betonimin e traut shtangues me dimensione axb=70x50cm në tërë gjatësinë e mureve të lumit, duke e llogaritur armimin minimum 4 Ø12 mm, stafa Ø 8mm/25cm dhe kallupimin.	m³	144.20	125.00	18,025.00
4,0,1	Sigurimi, transporti i gurëve me trashësi minimale 20cm, vendosja në beton të fresket C-20/25 në shtresa gurë+beton=20+20=40cm në shtratin e rregulluar.	m³	960.00	60.00	57,600.00
4,0,2	Punimi i objekteve tërthore, kaskade në breze me betonarme hidroteknik C-25/30, dhe vendosja e armatës rrejet Q524.	m³	345.00	130.00	44,850.00
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT BETONUSE DHE MURATUSE					120,475.00
II. Muret e reja nga ri-projektimi					



II.1	Punët e Gërmimit				
1	Gërmimi i dheut te kategoris III-IV ne brigjet e lumit dhe per hapjen e themeleve për muret mbrojtëse, dhe bartja e tij ne deponi te pershtatshme ne largesi deri ne 15 km.	m³	1,016.91	2.00	2,033.83 €
II.2	Punët e Zhavorit				
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë mbushes 0-150mm mint=55cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >50 MPa. Në këtë pozicion është llogaritur sasia e materialit mbushës nen themelet e mureve mbrojtëse.	m³	131.09	8.00	1,048.69 €
2	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-63mm, t=15cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv>80 Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur sasia e materialit mbushës nen themelet e mureve mbrojtëse.	m³	50.00	12.00	600.00 €
II.3	Demolimi i mureve ekzistuese				
1	Demolimi i murit nga betoni i armuar ne fundin e lumit (st. 0+351.32 km). Muri ka lartësi h=2.0 m dhe trashesi t=25 cm-30 cm. Ne këtë pozicion të përfshihet edhe transporti i materialit ne deponi të materialeve inerte.	m'	13.50	50.00	675.00 €
II.4	Punimi i Mureve mbrojtës				
1	Furnizimi,punimi i armatures se brinjzuar S400/500 profile Ø8 mm, Ø10 mm, Ø12 mm dhe Ø14 mm	kg	36,015.78	0.70	25,211.05 €
3	Furnizimi dhe vendosja ne veper e betonit C-25/30 për betonimin e mureve mbrojtëse në skarpamet e lumi, duke e llogaritur edhe kallupimin. Muret kane lartesi mesatare h=3.0-5.0 m.	m³	568.50	125.00	71,062.50 €
4	Furnizimi dhe lyrja e mureve mbrojtëse në pjesët ku kanë kontakt me dhe me material hidroizoluese (jo ujëpërshruesë),	m²	1,231.95	2.00	2,463.90 €
5	Furnizimi dhe shtrirja e gypit drenazhues (te brinjzuar) Ø 160 mm	m'	139.10	2.50	347.75 €
6	Furnizimi dhe shtrirja e gjeotekstilit për drenazhim, 250 gr/m²	m²	125.25	1.50	187.88 €
7	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorrit 20-40 mm për drenazhim	m³	26.98	10.00	269.80 €
Gjithsej totali me TVSH - Muret e reja nga ri-projektimi					103,900.39
5,0,0	PUNËT TJERA				
5,0,1	Punimi i pusetave dhe vendosja e gypave Ø200 per shkarkimin e ujrave fekale,punimet bëhen sipas detalit.	copë	15.00	500.00	7,500.00
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT TJERA					7,500.00

Rekapitullimi		
1,0,0	PUNËT PARAPRAKE	4,054.40
2,0,0	PUNIMET E DHEUT	39,506.10
3,0,0	PUNËT E ZHAVORIT	36,849.62
4,0,0	PUNIMET BETONUSE DHE MURATUSE	120,475.00



II	Muret e reja nga ri-projektimi	103,900.39
5,0,0	PUNËT TJERA	7,500.00
Gjithsej totali me TVSH		312,285.51

- Segmenti i tretë, me gjatësi L3 =0+625.10 km i projektuar nga Infra Plus, Mars 2012	
Disa pjesë të këtij segmenti të Lumit nuk korrespondojnë me gjendjen e projektuar, andaj në disa pjesë skarpate e veshur me gurë natyror sipas projektit, zëvendësohet me mure mbrojtëse, me lartësi h=3.00-5.00m.	
I. Pjesë e ndryshuara te segmenti i tretë nga gjendja e projektuar:	
1. Ana djathtë kalon në mure mbrojtëse nga P13 st 0+302.27 km deri në st 0+414.79 km.	
2. Ana majtas kalon në mure mbrojtëse nga st :0+366.32 km deri në P17 st:0+400.00 km.	
II. Punët e përfunduara nga investitori në këtë segment:	
1.1. Ana djathtë nga P1 st 0+000.00 km deri në P11 st 0+238.01 km, l=238.01 m`	
1.2. Ana djathtë nga st 0+414.79 deri në P23 st 0+551.29 km, l=136.50 m	
2. Ana majtas nga P1 st 0+000.00 km deri në P14 st 0+0319.66 km, l=319.66 m`	
III. Është hekur rregullimi i pjesë se poshtme te shtratit te lumit dhe është shtuar një tra shtanguesë 70x50 cm	

Projekti kryesor i rregullimit të shtratit të lumit Krena pjesa IV-1 (Pjesa Veriore), Gjakovë					
Paramasa dhe Parallogaria Rrugët					
I. Aksi 1 L=0+202.85 km, B=5.50 m, II. Aksi 2 L=0+050.00 km, B=4.00 m, ΣL=0+252.85 km					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I	Punët Pregaditore				
1	Punët pregaditore dhe mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve.	komplet	1.00	1,000.00	1,000.00 €
2	Pastrimi i ternit kontrollimi i instalimeve nentokesore dhe largimi të gjitha pengesave të ndryshme në trasen e rrugës. Ne raste demtimi te instalime ekzistuese duhet ti rregulloj vetë punëkryesi.	m'	252.85	5.00	1,264.25 €
3	Shenjëzimi i trasesë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet.	m'	252.85	5.00	1,264.25 €
4	Inçizimi dhe punimi i projektit te gjendjes se ekzekutuar (në rast të ndryshimit nga gjendja e projektuar).	m'	252.85	1.00	252.85 €
Gjithsej totali me TVSH					3,781.35 €
II	Punët e Gërmimit				
1	Gerryerja e asfaltit dhe deponimi në vendin e caktuar nga investitori. Rrugët kanë një shtres asfalt me trashësi 8 cm.	m ²	2,275.65	5.00	11,378.25 €



2	Gërmimi i shtresave të rruges ekzistuese në trupin e rrugës. Shtresat ekzistuese janë nga zhavori I lumit. Materiali gurorë duhet të deponohet në vendin e caktuar nga investitori, ndërsa materiali i gërmuar nën shtresat e trupit të rrugë duhet të transportohet deponi te pershtatshme ne largesi deri ne 5 km.	m³	300.95	5.00	1,504.77 €
3	Nivellizimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv 40 MPa.	m²	2,654.93	2.50	6,637.33 €
Gjithsej totali me TVSH					19,520.34 €
III	Punët e Zhavorit				
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë rrethanor mbushes. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >40 MPa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqjeve anësore.	m³	264.45	10.00	2,644.50 €
2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë mbushes 0-150mm t=30cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >60 MPa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqjeve anësore.	m³	455.97	10.00	4,559.66 €
3	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-63 mm, t=20cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv>90 MPa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqjeve anësore.	m³	301.38	12.00	3,616.51 €
4	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31.5 mm t=10cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >120MPa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqjeve anësore.	m³	149.41	15.00	2,241.08 €
5	Furnizimi, shtrirja dhe kompaktimi i zhavorit (material shterp nga gurthuesit) për punimin e bankinave, t=12 cm.	m³	16.60	15.00	249.00 €
Gjithsej totali me TVSH					13,310.75 €
IV	Punët e Asfaltit				
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit BA 0/22 mm në rrugë, t=8cm	m²	2,202.10	15.00	33,031.50
2	Spërkatja (lyrja) e shtresës se parë te asfaltit me emulzion	m²	2,202.10	2.00	4,404.20
3	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit AB 11 mm në rrugë dhe kyçe e rrugeve ekzistuese, t=4cm	m²	2,202.10	10.00	22,021.00
4	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit AB 16 mm në rrugë dhe kyçe e rrugeve ekzistuese, t=8cm	m²	209.00	15.00	3,135.00
Gjithsej totali me TVSH					62,591.70 €
VII	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit				
1	Testimet e Ngjeshmëris	komplet	1.00	200.00	200.00 €
2	Testimet e Asfaltit	komplet	1.00	200.00	200.00 €
Gjithsej totali me TVSH					400.00 €
Rekapitullimi					
I	Punët Pregaditore				3,781.35 €



II	Punët e Gërmimit	19,520.34 €
III	Punët e Zhavorit	13,310.75 €
IV	Punët e Asfaltit	62,591.70 €
V	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit	400.00 €
Gjithsej totali me TVSH		99,604.14 €

Projekti kryesor i rregullimit të shtratit të lumit Krena pjesa IV-1 (Pjesa Veriore), Gjakovë					
Paramasa dhe Paralogaria					
URA - Automobilistike					
st. 0+082.10 – 0+102.56 km , L=21.10 m`					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I	Punët Pregaditore				
1	Punët peregaditore për fillimin e puneve. Transporti i makinerise dhe organizimi i vendpunishtes si dhe punet tjera të nevojshme për fillimin e ndërtimit.	komplet	1.00	1,000.00	1,000.00 €
